



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:225139
Datë: 24.05.2024
Numri i dokumentit: 05730541

E.nr.725//2009

GJYKATA THEMELORE MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Genc Hasani dhe me bashkëpunëtoren profesionale Valbona Tahiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Dogana e Kosovës – Prishtine, kundër debitorit G. B. nga M., lidhur me realizimin e borxhit, në bazë të Aktvendimit të Doganës së Kosovës K.nr. ..., i dt. ..., gjykata ka lejuar përmbartimin me Aktvendimin E.nr ..., të datës ..., jashtë seancës, me datën 23.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PEZULLOHET procedura përmbartimore e kreditorit Dogana e Kosovës – Prishtine, kundër debitorit G. B. nga M., , lidhur me realizimin e borxhit, në lartësi prej ... euro.

A r s y e t i m

Kreditori Dogana e Kosovës – Prishtine, më datë ..., ka parashtruar propozim për ekzekutim, në bazë të aktvendimit K.nr. ..., i dt..., lidhur me përmbartimin e borxhit në lartësi prej ... euro, kundër debitorit G. B. nga M., , Rr “Mustafe Venhari” - Mitrovicë.

Organi përmbartues me Urdhrin P.nr... të datës ..., e ka lejuar përmbartimin sipas propozimit të kreditorit.

Gjykata, me aktvendimin e datë ..., ka urdhëruar të gjitha bankat që operojnë në Republikën e Kosovës, mjetet monetare të debitorit G. B. nga M., në emër të borxhit në Shumen prej ...euro t’i barten në xhirollogarinë e kreditorit Dogana e Kosovës – Prishtine. Me parashtrësën e pranuar nga Bankat e Kosovës, vërtetohet se debitori G. B. nga M., nuk posedon mjete dhe i ka mbyllura të gjitha llogarit bankare.

Gjykata duke u bazuar në dispozitat e LPP-së, më saktësisht nenin 65 i cili flet për pezullimin e procedurës përmbartimore, e në rastin konkret gjykata konstaton se janë plotësuar kushtet sipas dispozitës së lartcekur për pezullimin e procedurës në këtë çështje juridike përmbartimore.

Gjykata duke u bazuar në nenin 65 paragrafi 2 të LPP-së, i cili thotë “*Procedura e pezulluar me konkluzion nga paragrafi 1. i këtij neni mund të vazhdojë nëse kreditori në afatin prej gjashtë*

(6) muajsh paraqet informata të reja lidhur me çështjen e pezulluar, në të kundërtën procedura konsiderohet e përfunduar”.

Andaj nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi e në vështrim të nenit 65 të LPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
E.nr .725/09, më datë 23.05.2024

Gjyqtari
Genc Hasani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa brenda afatit 7 ditorë nga dita e pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Mitrovicë.